



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.57/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Komuna Prizren, parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.07.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.57/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 29.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.57/2026, nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, parashtruar kundër vendimit të KQZ-së të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, me të cilën pretendojnë se në qendrën e votimit 2034 në SH.F.M.U. "Qerim Maku", Velezhë, subjekti politik Koalicioni Vakati ka realizuar 94 vota, subjekt ky që garon për vendet e rezervuara për komunitetin boshnjak, mirëpo bazuar në ASK/ReKos 2024, fshati Velezhë ka gjithsej 395 banorë, prej të cilëve 394 janë shqiptarë, përkatësisht 99,75%, dhe vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak, përkatësisht 0,25%. Tutje kanë theksuar se ky raport prej 94 vota për subjektin politik që garon për vendin e garantuar boshnjak në një vendbanim me vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak paraqet një disproporcion të qartë dhe të verifikueshëm ndërmjet strukturës demografike dhe rezultatit zgjedhor.

Kanë kërkuar nga PZAP që ta miratojë këtë ankesë si të bazuar në tërësi ose pjesërisht, të hapë procedurë të plotë verifikimi të ligjshmërisë së përdorimit të votave të Koalicionit Vakati të

fituara në qendrën e votimit 2034 - Velezhë në përlllogaritjen për vendin e garantuar boshnjak; Të urdhërojnë verifikimin e të gjitha materialeve relevante zgjedhore për qendrën e votimit 2034, përfshirë fletëvotimet, formularët e rezultateve, procesverbalet e këshillave të vendvotimeve dhe vërejtjet eventuale të vëzhguesve; Të konstatojë nëse 94 votat e Koalicionit Vakant nga qendra e votimit 2034 mund të përdoren për shpërndarjen e mandatit të garantuar boshnjak, duke pasur parasysh strukturën zyrtare demografike të vendbanimit dhe qëllimin kushtetues të vendeve të garantuara; Nëse konstatohet se votat e përmendura janë përdorur në kundërshtim me qëllimin e përfaqësimit të garantuar, të urdhërojnë KQZ-në që t'i përjashtojë këto 94 vota nga përlllogaritja për shpërndarjen e vendit të garantuar boshnjak dhe të bëjë korrigjimin e rezultateve në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr. 08/L-228 dhe praktikën e PZAP-it/Gjykatës Supreme; Të zbatojë të njëjtin standard juridik si në lëndën A.nr. 656/2021, duke marrë parasysh krahasueshmërinë faktike dhe juridike të rastit, si dhe detyrimin për mbrojtjen e përfaqësimit autentik të komuniteteve jo shumicë.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja ka deklaruar se bazuar në nenin 6, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme rezulton qartë se sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës nuk e kushtëzon të drejtën e votës me përkatësinë etnike të votuesit. Tutje theksojnë se pretendimet e palës ankuese se rezultatet zgjedhore në qendrën e votimit 2034-SH.F.M.U “Qerim Maku” në Velezhë nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë, nuk përbejnë bazë ligjore për kontestimin e vlefshmërisë së votave apo rezultatit zgjedhor. Një pretendim i tillë nuk mbështetet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë të drejtën e votës dhe administrimin e procesit zgjedhor në Republikën e Kosovës. Lista e Votuesve (LV) nuk përmban dhe as nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna që kanë të bëjnë me etninë e qytetarëve. Po ashtu Rregullorja Zgjedhore nr.03/2024 përcakton qartë se LV përmban vetëm të dhëna identifikuese dhe administrative, si emri dhe mbiemri i votuesit, numri personal i identifikimit, data e lindjes, adresa e vendbanimit, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e votuesit dhe ushtrimin e së drejtës së votës, por jo të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike të qytetarëve.

Tutje kanë theksuar se KQZ nuk ka as kompetencë ligjore, dhe as mundësi faktike për të identifikuar, verifikuar apo vlerësuar motivet e votimit ose përkatësinë etnike të votuesve, e rrjedhimisht as për të nxjerrë përfundime mbi baza etnike në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve. Ankesa e palës ankuese lidhur me shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve për një subjekt të caktuar politik nuk është e bazuar dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi. Vlefshmëria dhe pavlefshmëria e një fletëvotimi përcaktohet vetëm në bazë të kriterëve dhe rasteve të përcaktuara shprehimisht me legjislacionin zgjedhor dhe nuk mund të kushtëzohet apo të vlerësohet mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesit. Gjithashtu, në kuadër të Procedurave e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim, të miratuara nga KQZ më 23.05.2026, me nr. 01/955-2026, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 7 qershor 2026, janë paraparë shembujt për identifikimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Për rrjedhojë, një fletëvotim mund të shpallet i pavlefshëm vetëm në rastet e përcaktuara nga rregullat dhe procedurat zgjedhore, dhe jo mbi bazën e identitetit, përkatësisë etnike apo ndonjë karakteristike tjetër personale të votuesit.

Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë, pasi në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit dhe as përkatësia e tij etnike. Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit janë të përcaktuara në nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Në rastin konkret, ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, ndërhyrje në kutitë e votimit, cenim të zinxhirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit. Ajo mbështetet në interpretime statistikore të rezultatit zgjedhor. Të dhënat statistikore, në vetvete, nuk përbejnë provë juridike por ekzistencën e parregullsive zgjedhore. Pranimi i një qasjeje të tillë do të nënkuptonte vlerësimin e votave mbi bazën e pritshmërisë demografike dhe jo mbi bazën e respektimit të procedurave zgjedhore, gjë që do të cenonte parimin e sigurisë juridike dhe stabilitetin e rezultatit zgjedhor. Bazuar në të lartcekurat kane kërkuar nga PZAP që ankesën ta refuzojë si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e parashtresës së ankesës e cila pretendon se në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 7 qershor 2026, Koalicioni Vakrat, sipas të dhënave qendrore zgjedhore, në vendin e votimit nr. 2034 - Velezhë, Komunë e Prizrenit, mori 94 vota brenda llogaritjes për vendin e rezervuar për deputet të komunitetit boshnjak, nga ku fshati Velezhë në komunën e Prizrenit ka vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak, përkatësisht 0,25%, sipas vlerësimit të panelit janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime.

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se *“Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”*, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Paneli sqaron se në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të njëjtë komunitet në vendvotime të caktuara. Bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 të aplikueshme në rastin konkret. Paneli thekson se bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore.

Po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtë nen parasheh që: “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”* Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe

një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Për një situatë të tillë, ka edhe praktikë nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila me Aktgjykimin në rastin KI69/2021, ndër të tjera ka sqaruar se: Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregulloret e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Po ashtu sipas vlerësimit të panelit kërkesa për anulim të votave, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të 94 fletëvotimeve në vendvotimet nr.2034 në Velezhë, është e pa bazë edhe për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha të lartcekurat, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në mbështetje të nenit 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se votat për komunitetin boshnjak janë të manipuluar, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.57/2026 më datën 01.07.2026

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.30/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Faton Ademi dhe Faton Bajrami, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidates Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Komunën e Prizrenit, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 07 Qershor 2026, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.57/2026, të datës 01.07.2026, në seancën e mbajtur me datë, 06.07.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidates Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Komunën e Prizrenit, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP), ZP.Anr.57/2026, të datës 01.07.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.57/2026, të datës 01.07.2026, është vendosur: "REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.57/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375- 2026 i datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 07 Qershor 2026".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën pretendon se PZAP nuk ka zhvilluar një verifikim serioz, të plotë dhe të arsyetuar institucional, kjo pasi që në rastin konkret 94 vota të Koalicija Vakati janë realizuar në qendrën e votimit 2034 - Velezhë, në vendbanimin që sipas AKS/ReKos 2024 ka 395 banorë, prej të cilëve 394 janë shqiptarë dhe vetëm një boshnjak. Pastaj ka pretenduar se PZAP nuk ka shpjeguar pse standardi i vitit 2021 nuk zbatohet në një situatë ku provat e vitit 2026 janë më objektive, më të freskëta dhe zyrtarisht të pranuar. Veçanërisht shpjegoi se kjo arsyetuar pse Koalicija Vakati në vitin 2021 ka mundur të trajtohet përmes standardit të vitit 2021.



objektive në mjediset me shumicë serbe, ndërsa në vitin 2026 i njëjti standard refuzohet në mjedisin me shumicë shqiptare Velezhë, si rrjedhojë ka pretenduar se vendimi i PZAP është i përfshirë në shkelje procedurale, zbatim të gabuar të drejtës materiale, kostatim jo të plotë të gjendjes faktike dhe arsyetim të pamjaftueshëm. Andaj nga arsyet e lartcekura ka propozuar që Gjykata Supreme ta aprovoj ankesën, ashtu që të shfuqizoj vendimin e PZAP-së, dhe ta kthej lëndën në rivendosje me udhëzime të qarta që ta obligoj PZAP-n ta trajtojë lëndën si çështje kushtetuese dhe ligjore të mbrojtjes së vendeve të garantuara, përfaqësimit autentik dhe standardit të barabartë juridik.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.57/2026, i datës 01.07.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.57/2026, nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, parashtruar kundër vendimit të KQZ-së të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, me të cilën pretendojnë se në qendrën e votimit 2034 në SH.F.M.U. "Qerim Maku", Velezhë, subjekti politik Koalicioni Vakati ka realizuar 94 vota, subjekt ky që garon për vendet e rezervuara për komunitetin boshnjak, mirëpo bazuar në ASK/ReKos 2024, fshati Velezhë ka gjithsej 395 banorë, prej të cilëve 394 janë shqiptarë, përkatësisht 99,75%, dhe vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak, përkatësisht 0,25%. Tutje kanë theksuar se ky raport prej 94 vota për subjektin politik që garon për vendin e garantuar boshnjak në një vendbanim me vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak paraqet një disproporcion të qartë dhe të verifikueshëm ndërmjet strukturës demografike dhe rezultatit zgjedhor.

Kanë kërkuar nga PZAP që ta miratojë ankesën si të bazuar në tërësi ose pjesërisht, të hapë procedurë të plotë verifikimi të ligjshmërisë së përdorimit të votave të Koalicionit Vakati të fituara në qendrën e votimit 2034 - Velezhë në përlllogaritjen për vendin e garantuar boshnjak; Të urdhërojë verifikimin e të gjitha materialeve relevante zgjedhore për qendrën e votimit 2034, përfshirë fletëvotimet, formularët e rezultateve, procesverbalet e këshillave të vendvotimeve dhe vërejtjet eventuale të vëzhguesve; Të konstatojë nëse 94 votat e Koalicionit Vakati nga qendra e votimit 2034 mund të përdoren për shpërndarjen e mandatit të garantuar boshnjak, duke pasur parasysh strukturën zyrtare demografike të vendbanimit dhe qëllimin kushtetues të vendeve të garantuara; Nëse konstatohet se votat e përmendura janë përdorur në kundërshtim me qëllimin e përfaqësimit të garantuar, të urdhërojë KQZ-në që t'i përjashtojë këto 94 vota nga përlllogaritja për shpërndarjen e vendit të garantuar.



boshnjak dhe të bëjë korrigjimin e rezultateve në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr. 08/L-228 dhe praktikën e PZAP-it/Gjykatës Supreme; Të zbatojë të njëjtin standard juridik si në lëndën A.nr. 656/2021, duke marrë parasysh krahasueshmërinë faktike dhe juridike të rastit, si dhe detyrimin për mbrojtjen e përfaqësimit autentik të komuniteteve jo shumicë.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor ka deklaruar se bazuar në nenin 6, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme rezulton qartë se sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës nuk e kushtëzon të drejtën e votës me përkatësinë etnike të votuesit. Tutje theksojnë se pretendimet e palës ankuese se rezultatet zgjedhore në qendrën e votimit 2034-SH.F.M.U "Qerim Maku" në Velezhë nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë, nuk përbëjnë bazë ligjore për kontestimin e vlefshmërisë së votave apo rezultatit zgjedhor. Një pretendim i tillë nuk mbështetet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë të drejtën e votës dhe administrimin e procesit zgjedhor në Republikën e Kosovës. Lista e Votuesve (LV) nuk përmban dhe as nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna që kanë të bëjnë me etninë e qytetarëve. Po ashtu Rregullorja Zgjedhore nr. 03/2024 përcakton qartë se LV përmban vetëm të dhëna identifikuese dhe administrative, si emri dhe mbiemri i votuesit, numri personal i identifikimit, data e lindjes, adresa e vendbanimit, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e votuesit dhe ushtrimin e së drejtës së votës, por jo të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike të qytetarëve.

Tutje kanë theksuar se KQZ nuk ka as kompetencë ligjore, dhe as mundësi faktike për të identifikuar, verifikuar apo vlerësuar motivet e votimit ose përkatësinë etnike të votuesve, e rrjedhimisht as për të nxjerrë përfundime mbi baza etnike në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve. Ankesa e palës ankuese lidhur me shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve për një subjekt të caktuar politik nuk është e bazuar dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi. Vlefshmëria dhe pavlefshmëria e një fletëvotimi përcaktohet vetëm në bazë të kriterëve dhe rasteve të përcaktuara shprehimisht me legjislacionin zgjedhor dhe nuk mund të kushtëzohet apo të vlerësohet mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesit. Gjithashtu, në kuadër të Procedurave e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim, të miratuara nga KQZ më 23.05.2026, me nr. 01/955-2026, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 7 qershor 2026, janë paraparë shembujt për identifikimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Për rrjedhojë, një fletëvotim mund të shpallet i pavlefshëm vetëm në rastet e përcaktuara nga rregullat dhe procedurat zgjedhore, dhe jo mbi bazën e identitetit, përkatësisë etnike apo ndonjë karakteristikë tjetër personale të votuesit.

Pastaj kanë vlerësuar se pretendimet e palës ankuese janë të paqëndrueshme, pasi në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit dhe as përkatësia e tij etnike. Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit janë të përcaktuara në nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Në rastin konkret, ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, ndërhyrje në kutitë e votimit, cenim të zinxhirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit. Ajo mbështetet në interpretime statistikore të rezultatit zgjedhor. Të dhënat statistikore, në vetvete, nuk përbëjnë provë juridike por ekzistencën e parregullsive zgjedhore. Pranimi i një qasjeje të tillë do të nënkuptonte vlerësimin e votave mbi bazën e pritshmërisë demografike dhe jo mbi bazën e respektimit të



zgjedhore, gjë që do të cenonte parimin e sigurisë juridike dhe stabilitetin e rezultatit zgjedhor. Bazuar në të lartcekurat kanë kërkuar nga PZAP që ankesën ta refuzojë si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se e njëjta është e pabazuar. Paneli pretendimet e parashtrueses së ankesës e cila pretendon se në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 7 qershor 2026, Koalicioni Vakrat, sipas të dhënave qendrore zgjedhore, në vendin e votimit nr. 2034 - Velezhë, Komunë e Prizrenit, mori 94 vota brenda llogaritjes për vendin e rezervuar për deputet të komunitetit boshnjak, nga ku fshati Velezhë në Komunën e Prizrenit ka vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak përkatësisht 0,25%, sipas vlerësimit të panelit janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime.

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 të LZP-së, që parasheh se: "*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar. Paneli sqaron se në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligiin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 të aplikueshme në rastin konkret. Paneli thekson se bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore.

Po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: "*Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor*". Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: "*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*". Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Për një situatë të tillë, ka edhe praktikë nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila me Aktgjykimin në rastin K169/2021, ndër të tjera ka shprehur se Gjykatë



rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) Cdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloret e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregulloret e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Po ashtu sipas vlerësimit të panelit kërkesa për anulim të votave, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të 94 fletëvotimeve në vendvotimet nr.2034 në Velezhë, është e pa bazë edhe për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kësës për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha të lartcekurat, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në mbështetje të nenit 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se votat për komunitetin boshnjak janë të manipuluar, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklaramë dhe të pa argumentuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), për shkak të mos verifikimit serioz, të plotë dhe të arsyetuar institucional të votave, në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara në ankesë lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, respektivisht pretendimet për anulimin e 94 fletëvotimeve në qendrën e votimit 2034 në SH.F.M.U. "Qerim Maku", Velezhë, Komuna e Prizrenit, duke pretenduar se se raporti prej 94 vota për subjektin politik që garon për vendin e garantuar boshnjak në një vendbanim me vetëm një pjesëtar të evidentuar të komunitetit boshnjak paraqet një disproporcion të qartë dhe të verifikueshëm ndërmjet strukturës demografike dhe rezultatit zgjedhor, nga kolegji i Gjykatës Supreme vlerësohen të pabazuara. Kjo pasi që pretendimet e palës ankuese, të mbështetura në mospërputhjen e supozuar ndërmjet rezultateve zgjedhore në qendrën e votimit 2034-SH.F.M.U. "Qerim Maku" në Velezhë dhe strukturës demografike të popullsisë së asaj zone, nuk përbëjnë, në vetvete, bazë ligjore për të vënë në diskutim



vlefshmërinë e votave apo rezultatin zgjedhor, duke marrë për bazë faktin se legjislacioni zgjedhor në fuqi nuk parashikon strukturën etnike të popullsisë si kriter për vlerësimin e ligjshmërisë së votimit apo të rezultatit zgjedhor. Ankuesja në ankesën e paraqitur i është referuar shkeljeve esenciale të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me pretendim se arsyetimi i vendimit të PZAP është juridikisht i paplotë, kjo pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka kërkuar anulimin etnik të votave, por verifikimin e ligjshmërisë së përdorimit institucional të votave nga një mjedis shumicë shqiptare për realizimin e një mandati të garantuar boshnjak, mirëpo pretendimet e tilla nga ana e Gjykatës Supreme janë vlerësuar të pabazuara, kjo pasi që vlerëson se vendimi i PZAP, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të ankueses, përkitazi me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, respektivisht mospërputhjet serioze ndërmjet rezultateve zyrtare dhe realitetit demografik në qendrën e votimit 2034 në SH.F.M.U. "Qerim Maku", Velezhë, Komuna e Prizrenit, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankueses, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme, pasi që nga pretendimet e theksuara në ankesë nuk është vërtetuar se ka pasur manipulim të fletëvotimeve, ndërhyrje në kutitë e votimit, cenim të zinxhirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit, që do të ndikojnë në ligjshmërinë e rezultatit zgjedhor. Si rrjedhojë, të njëjtat pretendime, nga ana e parashtueses të ankesës në Gjykatën Supreme, janë vlerësuar të paqëndrueshme, kjo pasi që në këtë rast nuk mjaftojnë vetëm interpretimet statistikore për të mbështetur pretendimet ankimore pa u mbështetur në prova konkrete.

Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe me të drejtë është konstatuar se Lista e Votuesve nuk përmban të dhëna mbi përkatësinë etnike të votuesve dhe se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mbledh, administron apo përpunon të dhëna të tilla. Kjo për faktin se ankuesja në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka ofruar asnjë dëshmi dhe provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Përveç kësaj është i drejtë edhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it se në rastin konkret, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Në anën tjetër, edhe për kolegjin e kësaj gjykate është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it i dhënë lidhur me pretendimet e palës ankuese se nuk ka asnjë bazë ligjore për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimin e lartcekur, duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Po ashtu Gjykata Supreme ka vlerësuar të drejtë konstatimin dhe vlerësimin e PZAP-it, se referuar Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve. Si rrjedhojë e kësaj, tani pretendimet ankimore të parashtuara nga ankuesi për shkeljet e pretenduara si më lartë janë të pabazuara, pasi që referuar nenit 6 pa



i LZP-së, parashihet qartazi se: *"Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar*".

Kolegji i Gjykatës Supreme i vlerësoi edhe pretendimet e ankueses, të cilat i referohen praktikës së mëparshme për situata të ngjashme, përkatësisht vendimmarrjes përmes vendimeve të PZAP A.nr.656/2021 dhe A.nr.736/2021, të cilit i është referuar ankuesja në ankesën e parashtruar, mirëpo erdhi në përfundim se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se, referuar shkresave të lëndës, përkatësisht vendimit të atakuar të PZAP-it, rezulton se ky i fundit për çështjen kontestuese me të drejtë i është referuar aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 26.05.2023, në rastin nr.KI69/21 Parashtrues Partia Liberale Egjiptiane (PLE) dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK). Në lidhje me këtë, përkatësisht për çështjet e ngritura me ankesë nga këtu ankuesi, Gjykata Kushtetuese në pikën 196 të këtij aktgjykimi, ka theksuar se: *".... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime."* Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: *"Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit."*

Si rezultat i kësaj, si dhe për faktin se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, konform nenit 4 paragrafi 6, lidhur me nenin 112 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, si dhe bazuar në nenin 116 paragrafi 1, të kushtetutës ku shprehimisht përcaktohet se: *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"*, tani vendimmarrja e Gjykatës Supreme për çështjet e trajtuara nga Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin nr.KI69/21, të datës 26.05.2023, e të cilat edhe janë objekt i ankesës së ankuesit (*të cilat kanë të bëjnë me kërkesën për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotime të caktuara, duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve*), bëhet pikërisht në përputhje me këtë aktgjykim, përkatësisht me pikën 208, 209, 210 dhe 212 të tij.

Mbi këtë bazë, kolegji i Gjykatës Supreme i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet lidhur me atë se vendimi i PZAP ka cenuar qëllimin kushtetues të vendeve të garantuara, kjo për faktin se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga e cila rrjedh se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi



Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren Nr. 12/2024, dhe në mungesë të provave të qëndrueshme ka refuzuar ankesën e ankueses.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtrueses së ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.30/2026, datë 06.07.2026

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik